



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:054192
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05752583

PAKR.nr.222/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vaton Durguti kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Kadrije Goga- Lubishtani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.S, i akuzuar sipas aktakuzës për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 147 lidhu me nenin 20 të KPRK-së, e ri kualifikuar pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në veprën penale kanosje nga neni 161 par.2 të KPK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.112/2012, datë 04.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.112/2012, datë 04.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.112/2012, datë 04.03.2024, ndaj të akuzuarit K.S konform nenit 362 par.1 nënpar 1.3 të

KPP-së, shkak të veprës penale kanosje nga neni 161 par.2 të KPK-së, ka refuzuar akuzën, sepse me datën 18.02.2012, rreth orës ne Gj, në rr. i pandehuri me dashje e ka kanosur tani të dëmtuarin RR.R nga f. K. Gj, në atë mënyrë që gjersa i dëmtuari ishte duke qarkulluar me veturën e tij të markës “..... 190” me targa të regjistrimit nëpër qytet, për ballë , fillimisht i pandehuri e blinda me drita (i jep sinjal) duke e parë këtë gjendje i dëmtuari e ngadalëson shpejtësinë, ku i pandehuri me veturën e tij të markës “.....” me targa të regjistrimit, me ngjyrë të kaltër e godet me anën e djathtë të veturës së tij, veturën e të dëmtuarit në anën e majtë ne derën e vozitësit ku ishte në veturë, por duke e parë këtë gjendje i dëmtuari merre një shpejtësi me veturë dhe ikë nga vendi i ngjarjes me qëllim që ti shmangë veprimet e të pandehurit, për shkak të një konflikti të mëhershëm ndërmjet tyre, e më pas i dëmtuari lajmërohet në Stacionin policor në Gj.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale kanosje nga neni 161 par.2 te KPK-së.

Shpenzimet lidhur me këtë lëndë mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

I dëmtuari RR.R për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 383 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 384 par.2 nënpar.2.7 të KPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 383 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 386 të KPP-së dhe shkeljes se ligjit penal nga neni 383 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 385 të KPP-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj s ai përket pretendimeve ankimore dhe lëndën ta kthej në rivendosje.

Përgjigje në ankese ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit K.S, av.Elvira Haziri me propozim që ankesa e PTH-së të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.208/2024, datë 08.04.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigja në ankese e ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit K.S, av.Elvira Haziri të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës të nenit 390 par.1 të KPPRK-së, për të cilën nuk i njoftoi palët pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënimin me

burgim por për të pandehurit e ka refuzuar akuzën, prandaj njoftimi i palëve nuk është i detyrueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës në këtë çështje së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Prokurori në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara në nenin 384 par.2 nën par.2.7 lidhur me nenin 369 të KPP-të, për arsye se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, duke mos vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse, si dhe arsyet në të cilat është bazuar zgjedhjen e rastit të cilat nuk i potencon fare, por vetëm e bënë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në veprën penale kanosje e që pastaj e njëjta është parashkruar dhe ndaj akuzuarit është marr aktgjykim refuzues.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thekson se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor prandaj edhe si pasojë e kësaj ka arritur deri të vërtetimi i gabuar i vlerësimit të gjendjes faktike, të cilat po të ishin peshuar në mënyrë të duhur nuk do të kishte rezultat me aktgjykim refuzues, duke marrë për bazë provat e shtjelluara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë deklarata e të dëmtuarit RR.R, i cili ka deklaruar se ditën kritike përderisa sa ka qenë duke punuar si taksist, pasi e ka përfunduar një klientë, duke u kthyer për në qytet e vëren një veturë e markës “.....”, që po i shkon mbrapa dhe po e blindon me drita, i njëjti është kthyer me shkuar ka posta e madhe përsëri e ka blinduar duke i shkuar paralel me veturën e tij, e ka shtyrë ku aty e ka vërejtur që është K.S, me 2-3-persona, i cili me veturën e tij e ka goditë veturën e të dëmtuarit nga mbrapa, pastaj ka vazhduar duke e goditur në derën e pasme kah shoferi edhe njëherë në derën e parë të shoferit ku aty e ka humb kontrollin i cili e ka pas një revole në dorë duke ia bërë me dorë që të ndalet, ku i dëmtuari ka vazhdua me ikë me shpejtësi dhe ka shkuar ta lajmëroj rastin në polici. I dëmtuari ka deklaruar se K.S këtë veprim e ka ndërmarrë ngase i njëjti ka dashtë me u hakmarrë si pasojë e një konflikti me djalin e axhës për rastin e ndodhur gjatë vitit 2011, ku ka qenë prezentë në atë konflikt.

Se i akuzuari K.S e ka kryer veprën penale si në aktakuzë është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitareve zyrtareve policor B.TH dhe B.A të cilët kanë deklaruar se pasi është bërë

fotografimi i veturave është vërejtur që vetura e markës “.....” në pronësi të dëmtuarit RR.R është goditur në derën e përparme nga ana e shoferit, ndërsa sa i përket automjetit “.....” në pronësi të akuzuarit K.S është vërejtur një shenjë dëmtimi nga ana e djathtë të saj ku dyshohet se në të njëjtën pjesë është goditur vetura ”.....”. Kjo qëndron dhe kjo argumentohet me prova material siç janë fotot ku shihen dëmtimet e pësuar në të dy automjetet, si dhe nga raporti i forenzikës i datës 22.02.20212, ku janë përshkruar dëmtimet e veturave siç u përmenden me lartë.

Po ashtu nga provat e administruara rezulton se raportet mes të pandehurit K.S dhe të dëmtuarit RR.R, kanë qenë të acaruar për shkak të një konflikti paraprak që kanë pas në mes të dy familjeve dhe nga e gjithë kjo kuptohet se i akuzuari me dashje ka tentuar ta vrasë ta dëmtuarin, kjo vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarit i cili natën kritike e ka parë të akuzuarin K.S, se në dorë e ka pas revolen ngase vendi ka qenë i ndritshëm dhe ka mundur ta vëren të akuzuarin.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal thekson se qëndron se në veprimet e të akuzuarit dhe nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, shihet qartë se i akuzuari është kryerësi i veprës penale që i vihet në barrë, ngase me provat materiale të deponuara si dhe nga dëgjimi i të dëmtuarit dhe dëshmitareve, nuk ka asnjë mëdyshje se i njëjti është kryerës dhe përgjegjës për vepron penale të ngarkuar në aktakuzë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, duke i vlerësuar pretendimet ankimore, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPRK-së, apo shkelje tjera e të cilët kishin me kushtëzuar prishjen e detyrueshme të aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të plota, të qarta për faktet vendimtare si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike.

Aktgjykimi i ankimuar përmban shpjegimet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se arsyet e dhëna në aktgjykim janë të paqarta dhe kontradiktore me provat nga shkresat e lëndës, kjo gjykatë i gjen si të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se provat e ofruara dhe të

elaburuara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë rezultuar se provuari se në veprimet e të akuzuarit manifestohen elementë e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 147 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, mirëpo nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formësohen tiparet e veprës penale të ri kualifikuar kanosje nga neni 161 par.2 të KPK-së. Për rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 361 të KPRK-së, ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitareve, të cilat po të ishin peshuar në mënyrë të duhur nuk do të kishte rezultat me aktgjykim refuzues

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë ngase nga provat e kësaj çështje penale rezulton se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt relevant dhe vendimtar në këtë çështje penale nuk ka ngelur në nivel të dyshimit sikurse pretendon prokuroria në ankesën e ushtruar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësor administroi provat dhe dëshmitë, të propozuara si në aktakuzë, dhe atë: deklarami i të dëmtuarit RR.R dhe i dëshmitareve B.TH dhe B.A, si dhe provat materiale; fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës, sipas te cilit vetura (.....) vërehet në derën e vozitësit e dëmtuar-e shtypur, ndërsa vetura ka një dëmtim në anën e djathtë në mbrojtësin e përparmë dhe është lexuar raporti i forenzikës i datës 22.02.2012, ku janë përshkruar dëmtimet e veturave.

Nga faktet e konstatuar gjykata e shkallës së parë, pas analizimit të provave ka ardhur në përfundim se natën kritike tani i akuzuari K.S kishte dalë me veturën e tij “.....” në rrugët e Gj, duke përfshi rrugën dhe po ashtu këtë fakt i akuzuari vete e ka pranuar, po ashtu nga e dëshmitareve B.TH -hetues policor dhe B.A zyrtar policor nga Forenzika, është vërtetuar se vetura “.....” ka një dëmtim-shtypje në derën e vozitësit, ndërsa vetura “.....” një dëmtim në pjesën e përparme të djathtë në mbrojtësin e përparëm, dhe po ashtu këto dëmtime përputhen pjesërisht edhe me deklaratën e të dëmtuarit RR.R, I cili kishte deklaruar se vetura e tij ishte goditë edhe

në derën e vozitësit nga vetura “.....” të cilën e drejtonte K.S, pavarësisht faktit se ky një gjë të tillë e ka mohuar.

Mirëpo në anën tjetër, gjykata nuk ka mundur të vërtetoi faktin se i akuzuari K.S të ketë poseduar armë-revole dhe ketë ia kishte drejtuar të dëmtuarit, ashtu siç pretendon i dëmtuari, për veç kësaj i njëjti ketë rrethanë e ka cekur vetëm në seancë gjyqësore, andaj në këtë relacion nuk janë realizuar elementet e veprës penale vrasje në tentativë, ngase për një veprim të tillë duhet të ekzistoi dashja e të akzuarit që ta privoi nga jeta të dëmtuarin, e në rrethana e rastit konkret dashja e tillë mbetet e paprovuar.

Duke i'u referuar të lartcekurave kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar ndonjë fakt vendimtar.

Prandaj, për veprën penale të ri kualifikuar kanosja nga neni 161 par.2 të KPPK-së dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se lidhur me këtë vepër penale ka arrit parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi siç rrjedh nga shkresat e lëndës koha e kryerjes së veprës penale për të cilën dyshohen të pandehurit është data 18.02.2012, ndërsa parashkrimi rrjedh nga kjo datë, ndërsa në kuptim të nenit 90 par. 6 të KPPK-së afati i parashkrimit është dy vjet nga kryerja e veprës penale së dënueshme me gjobë ose me burgim deri një vit, andaj deri me tani ka kaluar dyfishi i kohës së kërkuar dhe në këtë çështje ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, për rrjedhojë konform dispozitës së nenit 363 par.1 nepar.1.3 të KPP-së, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka marr aktgjykim refuzues.

Nga arsyet e sipërcekura Kolegji vlerëson se gjykata e shkallë së parë pas analizimit dhe vlerësimit të prove një nga një e të ndërlidhura me njëra tjetrën arriti në përfundimin të drejtë se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruara si në aktakuzë, ngase në bazë të fakteve dhe provave të argumentuara është vërtetuar se në veprimet e të pandehurve plotësohen tiparet e veprës penale të ri cilësuar kanosja nga neni 161 par.2 të KPPK-së, dhe se për këtë vepër penale bazuar në dispozitën e nenit 90 par.1 pika 1.6 të KPPK-së, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.222/2024

Datë: 28.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Vaton Durguti

Kadrije Goga -Lubishtani